



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. 2-D	Nr. Prot. 01-1419/14
Dep. 02	Prot. No. 22-04-2014
Nr. i faqes 02	Data 22-04-2014
PRISTINE	

DATË/A:	22.04.2014
REFERENC-Ë:	AKK-DLK 02-364/13
PËR/ZA/TO:	Shpend AHMETI, Kryetar i Komunës së Prishtinës;
CC:	Hysni HOXHA, Kryetar i Organit Shqyrtues të Prokurimit
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Sqarim

I nderuar zotëri AHMETI,

Në mbështetje të nenit 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (15.06.2008), nenit 5 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.1) si dhe nenit 18 (paragrafët 1, 2, 8 dhe 9) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit (Gazeta Zyrtare nr. 65, datë, 05.02.2010), në bazë të Reagimit të Organit Shqyrtues të Prokurimit në mediat e shkruara me datë 22.04.2014, Agjencia kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtejshëm: Agjencia) e sheh të nevojshme të ofrojë për opinionin publik këtë:

S Q A R I M

Agjencia në bazë të informatave të pranuar në mënyrë anonime, ka filluar procedurën e hetimeve paraprake në lidhje me dyshimet për parregullsitë gjatë aktiviteteve të prokurimit publik në Komunën e Prishtinës, kundër 4 (katër) zyrtarëve përkatës.

Gjatë zhvillimit të hetimeve paraprake Agjencia ka grumbulluar dokumentacionin relevant në lidhje me këto dyshime me ç'rast ka gjetur se Komisioni për Vlerësimin e tenderëve gjatë vlerësimit të një tenderi me datë 02.05.2013, në raportin e vlerësimit të tenderëve në kundërshtim me nenin 59 (paragrafi 4) të Ligjit nr. 04 L/042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare nr. 18, datë 19.09.2011), operatorin ekonomik e ka vlerësuar si të përgjegjshëm dhe në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit, duke e

plotësuar me PO rubrikën në të cilën është kërkuar “Deklaratë e Garancionit” e obligueshme nga prodhuesi dhe furnizuesi përveç tjerash edhe për pajisjet mjekësore përkatëse, edhe pse operatori ekonomik e ka poseduar autorizimin për 24 muaj vetëm për njëërën pajisje mjekësore e jo për edhe për pajisjen tjetër.

Më pas Komisioni i Vlerësimit i ka rekomanduar Drejtorit të Zyrës së Prokurimit të Komunës e Prishtinës lidhjen e kontratës me operatorin ekonomik. Me datën 11.06.2013, në kundërshtim me nenin 26 (paragrafi 1) të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik është lidhur kontrata me Operatorin Ekonomik. Nga kjo rezulton se në kundërshtim me dispozitën e lartcekur është nënshkruar lidhja e kontratës në mes të operatorit ekonomik dhe Autoritetit Kontraktues, përkatësisht Komunës së Prishtinës, ngase operatori ekonomik në fakt do të duhej të shpallej i papërgjegjshëm sepse si i tillë nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat të përcaktuara në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë.

Agjencia ka konstatuar se lidhur me këtë rast nuk ka pasur të dhëna të mjaftueshme apo dyshim të arsyeshëm se rasti mund të përbëjë vepër penale por ka ekzistuar dyshimi për shkelje administrative dhe në bazë të nenit 18 (paragrafi 8) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, rastin e ka përcjellë te organi administrativ kompetent përkatësisht në Komunën e Prishtinës.

Në pajtim me nenin 10 të Rregullores nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil (MAP, datë 09.06.2011), përcaktohet se çdo shkelje e dyshuar nga nëpunësi civil duhet të paraqitet te udhëheqësi i drejtpërdrejtë ose te udhëheqësi më i lartë administrativ. Në bazë të dispozitave të kësaj Rregulloreje Komuna e Prishtinës ka qenë e obliguar të zhvillojë procedurën disiplinore në lidhje me këto dyshime.

Po ashtu sipas nenit 18 (paragrafi 9) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Komuna e Prishtinës si organ administrativ kompetent në këtë rast është e obliguar që të njoftojë Agjencinë për procedimin e mëtejshëm të rastit dhe vendimin final.

Të gjitha veprimet e ndërmarra nga Agjencia në lidhje me këtë rast kanë qenë në kuadër të kompetencave ligjore të saj dhe në pajtim me legjislacionin në fuqi. Agjencia në asnjë rast kur adreson kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore në lidhje me dyshimet për shkelje administrative nuk kërkon nga organet kompetente administrative llojin e masës disiplinore që duhet të caktohet. Në këtë rast Agjencia ka kërkuar nga Komuna e Prishtinës që në bazë të të gjeturave në lidhje me këtë rast të fillojë dhe zhvillojë procedurë disiplinore por nuk ka propozuar llojin e masës që mund t’u caktohet zyrtarëve të përfshirë në këtë rast. Për më tepër qëllimi i kësaj kërkeje ka qenë të parandalojë veprimet e mundshme të cilat në të ardhmen mund të rezultojnë me vepër me natyrë të korrupsionit.

Me respekt!